



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 207 dt.29.10.1994

**PER**  
**MIRATIMIN E KOMISIONIT TE BASHKISE SE TIRANES**  
**PER ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT**  
**TE 6 NENTORIT**

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, në mbledhjen e dt.29.10.1994, pasi shqyrtoi edhe një herë propozimet e paraqitura nga subjektet politike që përfaqësohen në Këshillin e Bashkisë së Tiranës, për përbërjen e Komisionit të Bashkisë së Tiranës për organizimin dhe zhvillimin e referendumit i cili do të mbahet më 6 nëntor 1994 për miratimin e Projekt Kushtetutës së Shqipërisë, mbështetur në nenet.12 dhe 16 të Ligjit Nr.7866, dt.06.10.1994 “Për Referendumet” në kreun e II të Ligjit Nr.7573, dt.16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” si dhe në Udhëzimin Nr.1, dt.26.10.1994 të Komisionit Qendror për Referendumin

**VENDOSI**

1. Të anulohet vendimi i këtij Këshilli Nr.191, dt.20.10.1994 “Për miratimin e Komisionit të Bashkisë për Referendumin”
2. Të miratojë komisionin e ri të Bashkisë së Qytetit të Tiranës me këtë përbërje :

- 1.Kryetar Z. Vedat Sferdelli P.Demokratike
  - 2.Sekretar Z. Edmond Sevi P.Socialiste
  - 3.N/Kryetar Z. Lulzim Papajani P.Socialdemokrate
  - 4.Anëtarë Z. Ali Çeliku P.Demokratike
  - 5.Anëtarë Z. Afërdita Stefani P.Socialiste
  - 6.Anëtarë Z. Osman Lika P.Socialdemokrate
  - 7.Anëtarë Z. Arben Kameniku P.Republikane
  - 8.Anëtarë Z. Jorgo Vllaho P.Bashkimit D.Njeriut
  - 9.Anëtarë Z. Nikolin Kopshtari P.Demokristiane
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**